



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE**

Nr. 567 Prot.

Tiranë, më. 11.04.2024

**NJOFTIM PËR VEND TË LIRË PUNE**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, dhe Vendimit Nr. 364, datë 29.5.2019 të Këshillit të Ministrave “Për Funksionimin dhe Mënyrën e Zhvillimit të Veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”, Urdhërit të Kryeministrit, nr. 137, datë 21.10.2019, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”. të ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore shpall konkursin për pozicionin:

**SPECIALIST NË SEKTORIN E PLATFORMËS DIGJITALE PËR  
TRASHËGIMINË KULTURORE  
kategoria e pagës IV-2**

**1. KUSHTET PËR KONKURIM DHE KRITERET E VEÇANTA:**

**1.1 Kandidati duhet të plotësojë kushtet për konkurrim si vijon:**

- a) Të jetë shtetas shqiptar;
- b) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës;
- f) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- g) Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shtuar sipas këtij ligji.

**1.2 Kandidati duhet të plotësojë kërkesat e posaçme si vijon:**

- a) Duhet të ketë arsimin e lartë me diplomë të Nivelit të Dytë të njohur nga Ministria e Arsimit të Shqipërisë, në degët shkenca gjeo-inxhinierisë /teknologjisë së informacionit/ arkeolog/ arkitekt/inxhinier.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE**

- b) Të zotërojnë diplomë të nivelit "Master Shkencor" apo "Master Profesional" të përfituar në fund të studimeve të ciklit të dytë në degët shkenca gjeo-inxhinierisë /teknologjisë së informacionit/arkeologjisë/ arkitekturës/inxhinier.
- c) Të ketë eksperiencë pune jo më pak se 3 vjet në fushën përkatëse të diplomimit, të vërtetuar me librezë pune/vërtetim nga punëdhënësi.
- d) Të ketë aftësi për tu përshtatur me kushtet, teknologjinë dhe procedurat e reja të standardeve evropiane.
- e) Të zotërojnë gjuhën angleze. Të ketë njohuri në gjuhë të tjera përbën avantazh.
- f) Të ketë aftësi praktike të të punuarit në kompjuter, në programe dhe software: Paketa Microsoft Window (Word, Exel, Power Point, etj), si dhe programe Gis dhe programe të përpunimit të imazheve.
- g) Të ketë aftësi të mira për: përshtatje pune në grup; të ketë aftësi të përmbushë detyrat brenda afateve të përcaktuara; aftësi komunikimi, referimi dhe mbrojtje të të dhënave, analizave, vendimeve, monitorimit dhe raportimit.

**2. PËRSHKRIM PUNE “SPECIALIST NË SEKTORIN PLATFORMËS DIGJITALE  
PËR TRASHËGIMINË KULTURORE:**

- 1. Realizon punën e sektorit në përputhje me kërkesat e akteve ligjore e nënligjore për trashëgiminë kulturore.
- 2. Merr masa për njohjen, zbatimin dhe përmirësimin e legjislacionit që lidhet me sektorin.
- 3. Përgjigjet për përditësimin e platformës digjitale për veprimtarinë arkeologjike në Republikën e Shqipërisë, si një regjistër publik i aksesueshëm nga çdo subjekt i interesuar.
- 4. Ndjek dhe koordinon punën hedhjen e të dhënave digjitale të çdo aktiviteti nga veprimtaria arkeologjike të depozituar pranë ITKT-së, nga institucionet e specializuara dhe subjektet e licencuara në fushën e veprimtarisë arkeologjike në Republikën e Shqipërisë.
- 5. Përgjigjet dhe koordinon punën me sektorët e IKTK për realizimin e ngarkimit në sistemin WebGIS të materialeve të nevojshme për përmirësimin dhe përditësimin e platformës.
- 6. Përgjigjet për hartimin, përditësimin dhe publikimin e sistemit të informacionit digjital dhe hartën digjitale në lidhje me trashëgiminë kulturore materiale të paluajtshme.
- 7. Në bashkëpunim me sektorët e tjerë ushtron veprimtarinë në fushën e trashëgimisë për mbikëqyrjen, promovimin, publikimin e trashëgimisë kulturore materiale.
- 8. Përgjigjet dhe realizon kontrollin e listës së dokumenteve të detyrueshme që duhen ngarkuar në sistemin WebGIS nga përdoruesit me kredenciale të institucioneve shtetërore të specializuara/individë apo shoqëri të licencuara në fushën e arkeologjisë për



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE**

vëzhgim arkeologjik sipërfaqësor, sondazh/gërmim arkeologjik dhe gjetje arkeologjike sipërfaqësore.

9. Mban kontakt me IT e institucionit, për mbarëvajtjen e platformave digjitale, që të jenë funksionale gjatë të gjithë kohës.
10. Merr masa për bashkëpunimin me institucione të tjera të cilat kanë nevojë të njohin informacionin të tilla si ASIG, Bashkitë, AKPT, DRTK, Ministria e Kulturës, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, publiku dhe turistët.

**3. DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT:**

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë;

- a) Jetëshkrim i aplikantit;
- b) Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- c) Fotokopje të noterizuar diplomës;
- d) Fotokopje të noterizuar të listës së notave;
- e) Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- f) Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g) Vetë deklaram të gjendjes gjyqësore;
- h) Certifikata kualifikimi;
- i) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në protokollin e Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, **brenda datës 22.04.2024, ora 16:00.**

**4. REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK:**

Brenda 5 (pesë) ditëve nga përfundimi i afatit të aplikimit në datën **29.04.2024**, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore, do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve që plotësojnë kushtet për konkurrim, dhe do të shpallë në faqen e internetit të saj, listën e kandidatëve të kualifikuar që vazhdojnë konkurrimin, datën, orën dhe vendin ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk janë shpallur të kualifikuar, do të njoftohen me email nga Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore dhe kanë të drejtë të paraqiten pranë tij, për t'u njohur me arsyet e mos kualifikimit.

Ata mund të ankohen brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e listës. Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore, do të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 2 (dy) ditëve pune.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT  
INSTITUTI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE

**5. FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA:**

Kandidatët e kualifikuar për vazhdimin e konkurrimit, do të vlerësohen për:

**- Njohuritë mbi:**

- a) Ligji nr.76/2016, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- b) Ligjin Nr. 27/2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë” dhe aktet ligjore dhe nënligjore të tij;
- c) Vendimin Nr. 364, datë 29.5.2019 të Këshillit të Ministrave “Për Funkcionimin dhe Mënyrën e Zhvillimit të Veprimtarisë së Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore”;
- d) Kodin e Procedurave Administrative;
- e) Legjislacionin mbi konfliktin e interesit dhe parandalimin e tij;
- f) Legjislacionin për Kodin e Punës dhe rregullat e etikës në administratën publike.

**6. DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT:**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Instituti Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore do ti njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail) dhe do të shpallë fituesin në faqen zyrtare dhe në këndin e njoftimeve të publikuara pranë Institucionit.

Për sqarime të mëtejshme mund të kontaktoni në adresën elektronike të Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore [info@iktk.gov.al](mailto:info@iktk.gov.al).

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

**KLESTA QIRICI**

